



A.nr.293/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.293/2026, të datës 13.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.A dhe B.P, të cilët më autorizim të përbashkët i përfaqëson ankuesi A.A, nga Vushtrria, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.293/2026, të datës 13.03.2026, e parashtruar nga ankuesi A.A dhe B.P.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, në atë mënyrë që të përfundoj vlerësimi i rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2025 si dhe të behët përcaktimi i objektivave të punës për vitin 2026 për ankuesit, në pajtim më pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil A.A dhe B.P (*në tekstin e mëtejme referuar* Ankuesit), më datë 12.03.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gobv.net, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 13.03.2026, për shkak të mos vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025 dhe mos caktimit të objektivave për vitin 2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Akademia e Kosovës për Siguri Publikë, ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 1304/2026 e datës 13.03.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër protokoli 42 i datës 30.06.2016 për ankuesin A.A; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër protokoli 41 i datës 30.06.2016 për ankuesin B.P; Emailin e datës 20.11.2025 nga F.S për B.P, A.A, T.R, M.H, B.P; Emailin e datës 28.10.2025 nga A.A; Autorizimin e datës 13.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 17.03.2026; Emailin e datës 02.02.2026 nga Xh.K për Q.B; Emailin e datës 02.02.2026 nga K.J për Xh.k dhe F.S; Emailin e datës 02.03.2026 nga A.K për Sh.K; Emailin e datës 04.03.2026 nga Xh.K për A.K; Emailin e datës 08.01.2026, 20.01.2026 dhe 23.01.2026 nga Xh.K dërguar mbikëqyrësve në AKSP për përfundim të vlerësimit; Vendimin me numër protokoli 209 të datës 30.10.2025 për përfundimin e marrëdhënies së punës së A.A; Emailin e datës 01.09.2025 nga F.S për A.A; Akt Emërimit me Nr. 139/2025 i datës 01.07.2025 për A.A; Formularin për përcaktimin e objektivave të planit të punës për vitin 2025 për ankuesit datës 21.02.2025; Vendimin me numër protokoli 282 të datës 27.11.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Trajnime në AKSP.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesve janë të **bazuara sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se:

- Ankuesit janë të punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, dhe atë ankuesi A.A sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër protokoli 42, të datës 30.06.2016, ushtron pozitën *Zyrtar i Lartë për Trajnime dhe Zhvillim në Divizionin e Trajnimit*, ndërsa ankuesi Besnik Percuki, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër protokoli 41 të datës 30.06.2016, mban pozitën *Zyrtar i Lartë për Trajnime dhe Zhvillim në Divizionin e Trajnimit*.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesit, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendojnë se nuk është përfunduar vlerësimi i rezultateve në punës për periudhën janar-tetor 2025, pasi që mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në muajin tetor është pensionuar, për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2025 nuk është kryer vlerësimi i rezultateve në punës si dhe nuk është bërë përcaktimi i objektivave për vitin 2026, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L 197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë. Kërkojnë që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet institucioni që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025 dhe caktimin e objektivave për vitin 2026.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje juridike-administrative ju referua bazës ligjore në fuqi që rregullon çështjet ndërlidhur me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civile dhe atë:

I. Ligji Nr. 08/L 197 për Zyrtarët Publikë

-Neni 52: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i paracaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përgjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.

II. Rregullorja (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë:

-Neni 4: 1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NjMBNj siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij. 2. Plani individual i punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësin civil. 3. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë. 4. Përcaktimi i objektivave dhe plani individual për arritjen e objektivave bëhen në muajin Janar të çdo viti, përmes SIMBNj-së. 5. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit, të njësisë ku është i punësuar nëpunësi dhe në përshkrimin përkatës të punës. 6. Formulari i gjeneruar nga SIMBNj, ruhet edhe në dosjen individuale.

-Neni 10: 1. Nëpunësi civil vlerësohet për tërë vitin, nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor. 2. Procesi i vlerësimi në SIMBNj i nëpunësit civil realizohet nga 1 Janari deri më 28 Shkurt të vitit pasues. 3. Në rastin e vlerësimit në nivelet “e papranueshme” dhe “ka nevojë për përmirësim”, përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në, e institucionit, vendos që nëpunësi civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 4. Periudha e vlerësimit të veçantë sipas paragrafit 3 të këtij neni zgjat tre (3) muaj. 5. Në rastet të ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secili mbikëqyrës vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse të mbikëqyrjes. NjMBNj siguron që mbikëqyrësi që ndërrohet, bën vlerësimin për periudhën përkatëse në përfundim të mbikëqyrjes.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, dhe duke u bazuar në provat materiale të parashtruar nga palët në procedurë rrjedhë së pretendimi ankimi për mos përfundim të vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesit për periudhën 2025 është tërësisht i bazuar dhe së personat përgjegjës kanë dështuar në ndërmarrje të veprimeve të nevojshme në kuptim të përfundimit të vlerësimit të ankuesve për periudhën 2025. Rrjedhimisht, në kontekst të këtij përcaktimi Kolegji kujton faktet se fillimisht mbikëqyrësi i ankueseve i pensionuar më datë 30.10.2025, nuk kishte përfunduar procesin e vlerësimit të stafit vartës për periudhën janar-tetor 2025, siç parashihet me nenin 10 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet: 5. Në rastet të ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secili mbikëqyrës vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse të mbikëqyrjes...ndërsa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike përfundimin e marrëdhënies së punës së ish Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve (në cilësi të mbikëqyrësit të ankuesit) e kishte bërë në datën e pensionimit sipas Vendimit më numër protokoll 209, të datës 30.10.2025, veprim ky në kundërshtim më nenin 73 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 2. Nëpunësja/i civil informohet për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të plotësimit të moshës së pensionimit gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit nga njësia përgjegjëse.. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit afati 6 muaj është paracaktuar mbi kushtin që të ndermiren veprime të domosdoshme administrative juridike, ndërsa, në përgjigjen në ankesë të datës 17.03.2026, Divizioni për Burime Njerëzore i ASKP ka pretenduar së përmes e-mailit datës 01.09.2025 ka njoftuar mbikëqyrësin e ankuesve për pensionimin si dhe kryerjen e obligimeve ndaj institucionit, mirëpo, nëse i referohemi emailit të datës 01.09.2025, Kolegji nuk ka arrit të vërtetoj një pretendim të tillë, sepse e-mali në fjalë nuk përmban ndonjë kërkesë për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të ankuesve që të kryej vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-tetor 2025, në fakt

e-amili përmban citatin: “Duke shpresuar se jeni mirë me shëndet, ju njoftime se më datë 30.10.2025 arrini moshën e pensionimit. Ju falënderojmë për kontributin dhe përkushtimin tuaj gjatë viteve të punës, dhe ju urojë shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe sukses në çdo hap të mëtejshëm të jetës suaj,

Nisur, nga rrethanat si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin që vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 2025, duhet të përfundohet në mënyrë fizike nga mbikëqyrësi aktual i ankuesit, pasi vlerësimit fizik nga mbikëqyrësit e ankuesve për muajt nëntor dhe dhjetor 2025.

Përkitazi më pretendimin për mos përcaktim të objektivave të punës për vitin 2026, Kolegji duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, më të parashihet se: “1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NjMBNj siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij. 4. Përcaktimi i objektivave dhe plani individual për arritjen e objektivave bëhen në muajin Janar të çdo viti, përmes SIMBNj-së”, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueseve në bashkëpunim me nëpunësit duhet të përcaktojnë objektivat e punës për vitin 2026 në pajtim me kërkesat ligjore.

Bazuar për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative/Departamenti i Kontesteve të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.293/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.A si përfaqësues i përbashkët;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AKSP;
- Arkivit të KPMSHCK-së.